

FJALA E DEPUTETIT VULLNET SINAJ

E ENJTE 28 PRILL 2022

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Në një botë që po zhvillohet me shpejtësi, çështjet e sigurisë energjetike po marrin gjithnjë e më tepër rëndësi si faktor kyç për garantimin e këtij zhvillimi. Jo më kot çështjet e sigurisë energjetike janë çështje të sigurisë kombëtare. Në forumet botërore energjia ka qenë prej kohësh temë kryesore, por sot, në kushtet e luftës së Ukrainës, ajo është shndërruar në një debat prioritar e diskutim i përditshëm. Qeveria, e drejtuar nga Kryeministri Rama, ka një strategji të qartë: në mes të këtyre vështirësive të garantojë pavarësinë energjetike të Shqipërisë dhe realizimin e kësaj strategjie qeveria e bën në dy mënyra. E para, duke i diversifikuar sa më shumë burimet e energjisë.

E dyta, duke siguruar efektivitetin dhe prodhimtarinë maksimale në burimet aktuale. Strategjia e qeverisë parashikon me të drejtë që të mos mbetemi peng vetëm i hidrocentraleve dhe i reshjeve, që janë të domosdoshme për funksionimin e tyre. Po kështu, nuk mund të jemi të varur nga importi, pasi çmimet e energjisë në tregjet ndërkombëtare janë të paparashikueshme. Hapa konkretë po hidhen ditë pas dite për diversifikimin e burimeve të energjisë. Në fillim të korrikut, dy anije ose, më saktë, dy termocentrale të lundrueshme, që prodhojnë energji nga lënda djegëse, do të lidhen me sistemin e shpërndarjes dhe do të plotësojnë 15% të nevojave ditore për energji. TEC-i i Vlorës shënon një ecuri të shkëlqyer. Punimet për shndërrimin e tij nga një TEC me naftë, në një impiant modern prodhimi energjie me gaz të lëngshëm, udhëhiqen nga një konsorcium amerikan.

TEC-i, për të cilin qeveria shqiptare vazhdon të paguajë kredinë, edhe pse nuk u vu kurrë në punë për shkak të projektimit të gabuar të sistemit ftohës, është shndërruar tashmë në një projekt rajonal. Nuk më vjen mirë që ende sot nuk kanë dalë përpara përgjegjësia autorët e hedhjes dëm të 130 milionë eurove nga pagesat e taksapaguesve shqiptarë. Për shkak të mungesës së seriozitetit dhe të papërgjegjshmërisë në drejtimin e veprave publike, TEC-i i Vlorës ka të paktën 12 vjet në konservim, duke i shkaktuar një dëm të konsiderueshëm qytetit të Vlorës dhe buxhetit të shtetit. Fatmirësisht,

qeveria shqiptare ka një plan të qartë për vënien në efektivitet të TEC-it, i cili jo vetëm do të ndalojë hemorragjinë financiare, por edhe do të kontribuojë në formimin e sigurisë energjetike.

Porti i lundrueshëm në Gjirin e Vlorës do të furnizojë TEC-in. Lidhja e tij me gazsjellësin TAP ndërmjet tubacionit Fier-Vlorë do ta shndërrojë Shqipërinë në një qendër të shpërndarjes të gazit të lëngshëm drejt rajonit, por edhe drejt Europës, duke e ulur vartësinë e tyre nga gazi rus dhe duke kontribuar në sigurinë energjetike. Parku fotovoltaik i Karavastasë dhe ai i Spitallës jo vetëm shënojnë investimet e para serioze në fushën e energjisë diellore, por do të sjellin edhe një kontribut të çmuar në këtë sektor, duke ofruar energji të pastër dhe me çmim konkurrues. Mënyra e dytë e sigurimit të pavarësisë energjetike të Shqipërisë është duke e siguruar efektivitetin dhe prodhimtarinë maksimale të burimet aktuale.

Andaj, projektligji që po diskutojmë sot për marrëveshjen e huas për rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës, është një çështje që duhet të na përfshijë të gjithëve. Hidrocentrali i Fierzës është hidrocentrali i sipërm i kaskadës së lumit Drin dhe është vënë në funksion për herë të parë në vitin 1978. Për nga fuqia e instaluar, pozicioni dhe vëllimi i rezervuarit, Fierza luan rol kyç për shfrytëzimin, rregullimin dhe sigurinë e të gjithë kaskadës. Po ashtu, hidrocentrali i Fierzës është njësia gjeneruese më e rëndësishme në vendin tonë me një kapacitet prodhimi prej 500 megavatësh dhe luan rolin e rregullatorit 1-vjeçar të kaskadës së Drinit. Shfrytëzimi i këtij hidrocentrali për një periudhë 40-vjeçare ka bërë që gjendja teknike e agregateve të jetë kritike dhe të ketë nevojë për ndërhyrje urgjente.

Ndër vite është konstatuar gjendje jo e mirë teknike e turbinave, problematika në rendimentin e agregateve dhe në ruajtjen e gatishmërisë së punës së tyre. Kjo situatë rrezikon ndalesa të paplanifikuara të makinerive dhe rritje të problemeve teknike, duke sjellë një humbje në energjinë e prodhuar me rreth 53 gigavatorë në vit, e cila është e barabartë me një reduktim të kapacitetit prodhues me 4% në vit, duke shkaktuar humbje monetare prej 2,7 milionë eurosh në vit. Për këto arsye vjen edhe marrëveshja e huas, të cilën do ta ratifikojmë sot, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW Frankfurt) për rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës, e cila ka të bëjë me akordimin e një huaje prej 40 milionë eurosh, konkretisht për rehabilitimin e turbinave dhe agregateve të këtij hidrocentrali.

Kjo marrëveshje huaje është bazuar në marrëveshjen kuadër të datës 27.01.2021 ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë për bashkëpunim financiar 2019 për projektin e

rehabilitimit të hidrocentralit të Fierzës, qëllimi i së cilës është të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik të Republikës së Shqipërisë, duke siguruar furnizimin me energji për një kohë të gjatë, pa ndikime në mjedis, duke zgjeruar prodhimtarinë dhe shfrytëzimin e HEC-it të Fierzës edhe me më shumë se 30 vjet të tjera. Kjo energji e munguar do t'i detyrojë kompanitë e sektorit elektroenergjetik t'i drejtohen tregut rajonal, duke rritur kështu riskun për përballjen me çmime të larta të blerjes së energjisë, e cila mund të reflektohet edhe në nevojën për rritjen e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët e, për rrjedhojë, në cenimin e mirëqenies së tyre.

Të nderuar kolegë,

Realizimi i këtij projekti është i një rëndësie të veçantë në kushtet ku jemi sot, të një krize globale të jashtëzakonshme energjetike, ku çmimi i energjisë në tregun europian varion nga 250 euro deri në 550 euro megavatori. Realizimi i këtij projekti pritet të sjellë rritjen e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i i Fierzës me rreth 53 gigavatorë në vit, rritjen e eficiencës në prodhim me rreth 4%; reduktimin e kohës së nevojshme për mirëmbajtjen e aggregateve; rritjen e disponueshmërisë së veprës; reduktimin e kostove vjetore për mirëmbajtjen periodike; kontributin në reduktimin e emetimit të dioksidit të karbonit nga prodhimet e energjisë elektrike në rajon; rritjen e sigurisë së furnizimit të vendit me energji elektrike; rritjen e jetëgjatësisë dhe funksionimit edhe me 30 vjet të tjera të hidrocentralit.

Sot që flasim, në mbarë botën dhe në të gjitha vendet e Bashkimit Europian faturat e energjisë janë rritur nga 20% deri në 40%. Në Shqipëri çmimi i faturës mujore të energjisë elektrike për 768 mijë familje dhe 95 mijë biznese të vogla nuk ka ndryshuar dhe vazhdon të mos ndryshojë, sepse qeveria shqiptare ka vendosur ta paguajë diferencën e rritjes së çmimit të energjisë elektrike në tregjet ndërkombëtare nga buxheti i shtetit. Plot 28 miliardë lekë kushton kjo mburojë elektroenergjetike, që e kthen Shqipërinë në një ndër vendet e pakta ku kriza globale është e paprekshme për konsumatorin familjar dhe biznesin e vogël.

Në Facebook-un tim një komentues më shkroi: pse sa herë flasim deputetët, nuk ka shumë njerëz në sallë? Sot duhej t'i thosha atij komentuesit që qeveria ka menduar të bëjë edhe diversifikimin e çmimit të energjisë elektrike. Kush konsumon më shumë, paguan më shumë, sepse ka edhe më shumë të ardhura dhe kjo është më se e drejtë. Fillon nga mua i pari, vazhdon me ministrat e kabinetit dhe me të gjithë deputetët. por, siç duket, deputetët që mungojnë, nuk janë dakord me diferencimin e çmimit të energjisë në vendin tonë. Edhe një herë, të nderuar kolegë, duke vlerësuar se energjia është çështje e

sigurisë kombëtare dhe si e tillë na përket të gjithëve, ju ftoj të japim votën pro së bashku për projektligjin e shtruar për miratim. Faleminderit!